

PROCESVERBAL
nga seanca e 17 -të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 18.04.2024

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, L Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, mr. Emilija Petreska Kamenjarova, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, Dimitar Tanurov, Maja Damevska, Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr.Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: Dragana Veljanovska nga misioni vëzhgues i Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut OSBE (ODIHR).

Z. Petrushevski hapi seancën e 17-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 14:30 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota “pro”, miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 16-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 15.04.2024.
2. Propozim-vendim për anulimin e Vendimit PA1 nr.0802-89 datë 15.03.2024, për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar.
3. Raporti i dytë nga monitorimi i periudhës parazgjedhore – nga data 8 mars deri më 3 prill 2024.
4. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 16-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 15.04.2024, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Z. Trajçevski shpjegoi Propozim-vendimin për anulimin e Vendimit PA1 nr.0802-89, datë 15.03.2024 për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar. Ai ka shpjeguar se Këshilli në njërën nga seancat e mëparshme i ka hequr lejen këtij transmetuesi për shkak se në afatin e përcaktuar ligjor prej 30 ditësh, e më pas dhe në afatin plotësues prej 15 ditësh derisa ka vazhduar procedura për heqjen e lejes, nuk ka paguar kompensimin në vlerë prej 32.084.00. Por pas heqjes së lejes dhe publikimit të Vendimit në Gazetën Zyrtare të RMV-së, transmetuesi ka bërë pagesën e mjeteve. Gjithashtu, ka paguar dhe mjetet që paraqesin shpenzime financiare për Agjencinë lidhur me publikimin e Vendimit për heqjen e lejes dhe për inicimin e kontestit administrativ para Gjykatës Administrative. Ai deklaroi se të gjitha këto të dhëna dhe dokumente gjenden në materialet e dorëzuara nën pikën. Ai ka shpjeguar se tani janë mënjanuar arsyet për të cilat është hequr leja, dhe propozohet që Këshilli të marrë Vendim për anulimin e Vendimit PA1 nr.0802-89, datë 15.03.2024 të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, për heqjen e lejes për transmetimin në radio të SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar.

Z. Petrushevski deklaroi se do ta mbështesë vendimin dhe tha se kjo është një rrjedhë pozitive e punëve që përfundoi me gëzim për mediumin.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për anulimin e Vendimit PA1 nr.0802-89 datë 15.03.2024 të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, PA1 nr 08-95 datë 07.09.2023.

SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, detyrohet jo më vonë se data 26.04.2024, të përmbush detyrimet e mëposhtme financiare dhe të tjera, përkatësisht:

- të paguajë shpenzimet në shumë prej 3.287,00 denarë, me TVSH, për publikim të Vendimit për heqjen e lejes për transmetim në radio PA1 nr.0802-89 datë 15.03.2024 në ("Gazetën Zyrtare të RMV-së" nr.67/24) - me faturë nr.3050-6849/27 datë 27.03.2024 (nr. ynë ark. 05-1528/1 datë 28.03.2024);
- të paguajë shpenzimet në shumë prej 3.287,00 denarë, me TVSH, për publikimin e këtij Vendimi për anulimin e Vendimit për heqjen e lejes për transmetim në radio PA1 nr.0802-89 datë 15.03.2024, në Gazetën Zyrtare të RMV-së;

Vendimi i lartpërmendur hyn në fuqi më datë 26.04.2024, me kusht që SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, në kohë t'i përmbush të gjitha detyrimet financiare dhe të tjera, të përfshira në Vendim, ndaj Agjencisë dhe për këtë t'i dorëzoj provë Agjencisë.

Në lidhje me Vendimin e lartpërmendur të Këshillit, Agjencia duhet të informojë Gjykatën Administrative të RMV-së.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit vendimin e lartpërmendur ta publikojë në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 3

Z. Trajçevski shpjegoi Raportin e dytë nga monitorimi i periudhës parazgjedhore nga 8 mars deri më 3 prill 2024. Ai shpjegoi se konstatimi kryesor në Raport nga kjo periudhë është se ndër transmetuesit që i nënshtroreshin mbikëqyrjes në shërbimet programore të nëntë televizioneve kombëtare: shërbimi i parë dhe i dytë programor televiziv i Radio Televizionit të Maqedonisë TVM (TVM1 dhe TVM2 - Program në Gjuhën shqipe), TV Alsat - M, TV Alfa, TV Kanal 5, TV Sitel, TV Telma, TV 24 Vesti dhe TV 21-M, nuk ka pasur shkelje të Kodit Zgjedhor. Në njoftim ASHMA ka shqyrtuar të gjithë programin ditor të këtyre shërbimeve, por ka analizuar para së gjithash përmbledhjet në edicionet qendrore të lajmeve që kanë të bëjnë me temat parazgjedhore dhe zhvillimet e brendshme aktuale sociale dhe politike. Në këto përmbledhje transmetuesit raportuan në mënyrë të balancuar për aktivitetet e partive politike gjatë kësaj periudhe deri në fillim të fushatës dhe nuk kanë shkelur Kodin Zgjedhor. Nga një numër i caktuar transmetuesish ka pasur ankesa se nga parti politike të caktuara janë bojkotuar, përkatësisht me ftesë të këtyre mediave përfaqësues të partive politike nuk kanë marrë pjesë në emisionet e tyre informative. Ai shpreson se kjo praktikë do të ndalet, por edhe nëse nuk ndalet do të kenë mundësi të raportojnë në pjesët e emisioneve informative të përgatitura nga transmetuesit.

Z. Petrushevski deklaroi se e ka lexuar Raportin, për të cilin tha se ishte gjithëpërfshirës dhe i punuar mirë. Ajo që i pëlqeu është konstatimi i shërbimeve dhe vetë e ka vënë re në media, se numri më i madh i gazetarëve kanë punuar profesionalisht në periudhën e kaluar dhe nuk kanë rënë në nivelin e partive politike, ata mbajnë një nivel më të lartë gjë që për mediat rezulton mirë.

Z. Fidanoski tha se do ta mbështes Raportin, i cili në mënyrë elokvente, dhe për shije të caktuara dhe mënyrën abstrakte, jep një përmbledhje të detajuar se si ka kaluar fushata parazgjedhore në këtë periudhë. Sa i përket Raportit, ai tha se është bërë me profesionalizëm dhe përgjegjësi nga Shërbimi Profesional. Ai lidhur me këtë shtroi një pyetje, nëse krijohet përshtypja, sepse tashmë një përshtypje të tillë e ka marrë kur ka shqyrtuar Raportin tek disa nga transmetuesit që kanë qenë subjekt i mbikëqyrjes, nëse refuzimi për pjesëmarrje të disa strukturave politike në emisionet e tyre debative japin një çekuilibër kvantitativ për emisionet debatuese tek këta transmetues?

Ndihmës udhëheqësja e Sektorit për çështje programore mr. Emilija Petreska Kamenjarova, u përgjigj se duhet pasur parasysh se ky është një Raport për një periudhë para fillimit të fushatës, ku ende nuk mund të flitet për bilanc apo disbalancë. Natyrisht që refuzimi i pjesëmarrjes nga faktorë të caktuar politikë në programet e transmetuesve të caktuar reflektohet sidomos në emisionet debatuese apo intervista, sepse në lajme natyrisht mund të njoftohet pavarësisht nëse ndonjë parti bojkoton ndonjë televizion ose jo. Tani do të jetë interesante të shihet se si do të pasqyrohet e gjithë kjo në Raportin e rrethit të parë të zgjedhjeve parlamentare. Ai u pajtua se ka njëfarë dallimi në përbërjen e të ftuarve, por ka edhe mënyra se si e gjithë kjo të kompensohet, përmes ekspertëve, përmes një mënyre tjetër diskutimi, si për shembull për prezantimin e kandidatëve, ka shumë emisione në të cilat ekspertët flasin për kandidatët e ardhshëm për kryetar. Televizionet kanë mundësi se si ta kapërcejnë këtë. Gjithashtu, siç dihet edhe nga monitorimet e mëparshme, në raste të tilla ajo që është e rëndësishme është që media përmes reprizave të mos çojnë në prezencë të tepruar vetëm një opsion të caktuar politik.

Z. Fidanoski tha se është i kënaqur me përgjigjen dhe shpreson se të gjithë faktorët politikë që janë pjesëmarrës aktivë në këtë proces zgjedhor do t'i tejkalojnë paragjykimet e tyre, qëndrimet në lidhje me politikën editoriale të disa transmetuesve, pa marrë parasysh se a u pëlqen personalisht apo jo, dhe se ata do të kontribuojnë me prezencën e tyre në debate, tema, deklarata lidhur me procesin zgjedhor për të marrë një pasqyrë të plotë, të barabartë, sasiore dhe cilësore në prezantimin mediatik.

Z. Ajdini deklaroi se pranon Raportin, i cili si gjithmonë nga ana e shërbimit është punuar profesionalisht. Ai ka bërë një pyetje në lidhje me faqen 3 të Raportit, ku thuhet se redaksia e TV Alsat më 25 mars me vetë iniciativë ka dërguar shkresë në Agjencion me dëshmi se dikush po ushtron presion direkt dhe indirekt ndaj tyre. Ai ka shpjeguar se shkresë të tillë nuk ka marrë në e-mail dhe do të dëshironte që dëshmitë e dorëzuara nga TV Alsat t'i shihte.

Ndihmës udhëheqësja e Sektorit për çështje programore mr. Emilija Petreska Kamenjarova, sqaroi se mediat kontaktojnë dhe përmes telefonit me Agjencinë për të biseduar për këtë temë. Pas një bisede të tillë, TV Alsat vendosi të dërgojë një shkresë me foto të shkarkuar nga rrjetet sociale, për të cilat TV Alsat mendon se ata paraqesin kërcënim të drejtpërdrejtë nga një parti politike për televizionin. Shkresa është arkivuar dhe do t'u dorëzohet anëtarëve të Këshillit.

Z. Ajdini tha se nëse provat janë nxjerrë nga rrjetet sociale, nuk është i sigurt se sa për këtë ASHMA-ja është kompetente, por nëse është nga ueb-faqja e partisë, atëherë është krejt diçka tjetër.

Ndihmës udhëheqësja Petreska Kamenjarova shpjegoi se nuk është fjala për veprim nga ana e Agjencisë në bazë të dëshmive të tyre. Sigurisht, nëse TV Alsat ndihet i kërcënuar nga përmbajtja e fotove, duhet të kontaktojë organet kompetente që merren me hulumtimin dhe ndjekjen penale të këtij lloj dyshimi. Për Agjencinë është me rëndësi që mediat të paraqesin indikatorë në bazë të të cilëve mund të konstatohet gjendja faktike, dhe kjo është se kanë dërguar letër në të cilën paraqesin dëshmi se janë të injoruar nga një parti politike.

Z. Ajdini u pajtua se ajo që janë të injoruar (shpërfillur) nuk është aspak mirë, por megjithatë do të donte t'i shihte ato foto.

Udhëheqësja Petreska Kamenjarova shtoi se Agjencia u tregon transmetuesve se nëse diçka e tillë ndodh në periudhën e informimit gjatë kohës së fushatës zgjedhore duhet të kenë në e-mail, me shkrim ose me telefon përmes komunikimit SMS që atyre do tu shërbejë si tregues dhe dëshmi se kanë qenë të ftuar por kanë refuzuar. Në këtë drejtim ajo ka shpjeguar se shumë shpesh mediat vendosin të lënë një karrige bosh duke treguar se kush mungon në debat.

Z. Petrushevski tha se po të mos ishte diskutimi i drejtorit Trajçevski, z. Fidanovski, z. Ajdini dhe udhëheqëses Petreska Kamenjarova për median që është ankuar nga një parti politike, ndoshta edhe anasjelltas, situata do të ishte afër ideale. Megjithatë, situata nuk është katastrofike, as aq e keqe, përkundrazi në një përqindje të madhe prej 80-90% është mirë me mediat dhe partitë politike. Këto janë disa përjashtime që ai tani nuk është i sigurt se sa mund të zgjidhen për të mos bërë më shumë dëme dhe u bëri thirrje subjekteve që të bëjnë përpjekje që të sillen profesionalisht. Mediat nuk duhet të preken nëse përfaqësuesit e partive politike nuk duan të vijjnë, ai duhet të vazhdojë të raportojë në mënyrë objektive dhe të paanshme. Në lidhje me subjektet politike, ai tha që të krijohet një klimë më e madhe sociale për tejkalimin e këtij problemi. Problemi nuk është i madh, por ne nuk mund t'i mbyllim sytë para tij. Në lidhje

me Raportin, ai ka shpjeguar se Këshilli nuk e voton, ai është publikuar në ueb-faqen e ASHMA-së dhe beson se në një Raport përfundimtar do të përfshihen të gjitha këto informacione.

Pika 4

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**